

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU	
Nr.faq/Br.str. <u>65</u>		
Datë/Datum. <u>01. 04. 2019</u>		
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE		



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 01.04.2019

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më datë 26.03.2019, pas shqyrtimit të kërkesës Nr. 53, të datës 19.03.2019, të thirrur nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës, mbështetur në kërkesën e nënshkruar nga dhjetë anëtarë të Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 24, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, Ligjin për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje Nr. 03/L-018, Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi Nr. 05/L-021, nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori këtë:

DEKLARATË

Për adresimin e çështjeve për barazi gjinore në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Në planifikimin e Buxhetit të Komunës, të zbatohet mekanizmi për Buxhetin e Përgjegjshëm Gjinor;
2. Të bëhet plotësim-ndryshimi i Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë, ku përmes këtij ndryshimi gjinekologu dhe pediatri do të jenë pjesë e shërbimeve edhe përmes Statutit. Në nenin 6 ku përshkruhet veprimtaria në paragrafin 5, pas pikës 5.3, të shtohen edhe dy pika tjera si në vijim: 5.4 Gjinekologu dhe 5.5 Pediatër. Kjo pikë e deklaratës, plotësohet me pajtimin e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës:

Me kërkesën për përfshirjen në deklaratë të shërbimeve të gjinekologut, pediatri dhe radiologut, ku personeli mjekësor i këtyre shërbimeve përkatëse, rekomandohet që të pranohet si personel shtesë në shëndetësi, për komunën tonë nga Ministria e Shëndetësisë, meqë demografia në qytetin tonë është në rritje të vazhdueshme dhe nevoja për këto shërbime është e madhe.

3. Të përkrahen gratë në biznes dhe subvencionim të iniciativave lokale të grave;
4. Formimi/Fuqizimi i Komitetit për Barazi Gjinore, si trupë i Kuvendit të Komunës;
5. Formimi/Fuqizimi i mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje;

6. Masa parandaluese dhe dënuese ndaj gjuhës diskriminuese ndaj grave në institucionet lokale;
7. Raportim në bazë vjetore pranë Kuvendit të Komunës nga Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, Qendra për Punë Sociale dhe Komandantit të Stacionit të Policisë në Fushë-Kosovë, lidhur me rastet e dhunës në familje dhe jashtë saj;
8. Të sigurohet buxheti për blerjen e Mamografit, sipas vendimit të Kuvendit të Komunës;
9. Hapja dhe përkrahja financiare strehimores së viktimave të dhunës në familje dhe mbështetje për viktimat e dhunës;
10. Identifikimi dhe përkrahja për nënat vetëushqyese;
11. Të organizohen aktivitete të ngjashme si ajo “Java e gruas” ose “Java kundër stigmës” në nivelin komunal.

Përmes kësaj deklarate publike të Kuvendit të Komunës, propozohet të fuqizohen të gjitha pikat nga një deri në njëmbëdhjetë dhe kërkohet zbatimi i tyre, në periudhën e ardhshme me kontributin e institucioneve komunale dhe qendrore me veprime dhe aktivitete konkrete.

Deklarata e Kuvendit të Komunës i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës, Zyrës për Barazi Gjinore, Ministrisë së Shëndetësisë, Agjensisë për Barazi Gjinore dhe Arkivit.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës
Vjollca Konjusha

